

Ligjet dhe politikat që adresojnë të drejtën e arsimit:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës,
- Ligji për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme,
- Ligji për Arsimin Parauniversitar,
- Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional,
- Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur,
- Ligji për Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë,
- Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës
- Ligji për mbrojtjen e fëmijëve
- Ligji për barazi gjinore
- Ligji kundër Diskriminimit,
- Ligji kundër trafikimit
- U.A.nr.16/2011 për kalimin e nxënësit të shkollës së mesme të lartë prej një profili arsimor në tjetrin prej një shkolle në shkollën tjetër
- U.A.nr. 08/2018 për krijimin dhe fuqizimin e EPRBM në arsimin parauniversitar
- UA nr.03/2012 Njohja dhe barasvlera e dokumenteve të arsimit parauniversitar,
- UA. nr.86/2020 për sistemimin e nxënësve në shkolla, të cilët janë kthyer nga mërgimi e ju mungojnë dokumentet përkatëse arsimore,
- UA nr.01/2016” Organizimi i kurseve të gjuhës dhe mësimi plotësues”
- Udhëzimet për arsimin e të rriturve (U.A. nr. 01/14 dhe U.A. 12/2014, etj)
- UA.nr. 06/ 2022 për vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar të republikës së kosovës
- Sektorit të Arsimit 2022-26,
- Plani Nacional kundër braktisjes

Janë një varg konventash dhe standardesh ndërkombëtare, të cilat kërkojnë qasje dhe mundësi të barabartë në arsim cilësor, prandaj me ligjet tona, kemi detyrim të ndërmarrim të gjitha masat e nevojshme për të siguruar të drejtën e arsimit për të gjithë qytetarët, pa dallim gjinie, etnie, aftësie e gjendje tjetër.



Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit bën thirrje për sensibilimin e të gjitha institucioneve përgjegjëse: arsimore, shëndetësore, sociale, etj., bashkë me komunitetin e prindërve dhe grupet tjera të interesit, për t`u mobilizuar në parandalim, identifikim, raportim, referim dhe trajtim efikas të rasteve të braktisjes së shkollimit!

Kjo broshurë u përgatit dhe u shtyp nga MASHTI

Të gjitha të drejtat i përkasin MASHTI

[https:// www.masht-gov.net](https://www.masht-gov.net)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacija
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Mundësi të barabarta në arsim për të gjithë

Java kundër braktisjes
20-29 nëntor 2023

Kur flasim për shkollat dhe nxënësit/ fëmijët e arsimit parauniversitar, po i referohemi ekskluzivisht Konventës për të Drejtat e Fëmijës, si traktati që i mbulon në mënyrë gjithëpërfshirëse të drejtat e fëmijës në çdo cep të botës. Duke u thirrur në parimet bazë të kësaj konvente (**Mosdiskriminimi, pjesëmarrja, interesi më i lartë i fëmijës dhe mbijetesat e zhvillimi**), shtetet orientojnë politikatat nacionale, prandaj ato janë bazamenti i të drejtave universale për çdo fëmijë/ individ

Bazuar në këto parime, institucionet arsimore duhet të kujdesen për pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje në arsim cilësor, duke siguruar zhvillimin e fëmijëve brenda potencialit të plotë.

Ligjet aktuale të arsimit, bashkë me aktet nënligjore përcjellëse adresojnë mundësitë e barabarta dhe qasjen e gjithëpërfshirëse në arsim cilësor.

Barrierat e natyrave të ndryshme brenda sistemit arsimor, sidomos ato të qasjes në arsim, ndërlikohet me faktorët e shumtë individualë, familjarë, shoqërorë me kontekste të ndryshme sociale, ekonomike, shëndetësore e kulturore, kërkojnë qasje multidisiplinare, prandaj i kemi ligjet tjera relevante si: Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale, Ligji i Policisë, Shëndetësisë, tashmë Ligji për mbrojtjen e fëmijës, etj, që bashkë me rregulloret dhe mekanizmat tjerë institucionalë, e kërkojnë bashkëveprimin e plotë për të funksionuar si hallka të shtetit në adresimin e problemeve me të cilat ballafaqohemi.

Sipas legjislacionit në fuqi, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, komunat, institucionet arsimore dhe komuniteti, po marrin të gjitha hapat e arsyeshëm që institucionet arsimore të jenë cilësore, gjithëpërfshirëse, humane dhe të sigurta (kemi edhe sistemin e parandalimit dhe referimit të dhunës në shkolla) siç e kërkojnë politikatat arsimore, përfshirë standardet për shkollat mike, kurrikulat dhe secila hallkë e sistemit arsimor.

Sivjet kemi vazhduar mbështetjen e komunave për funksionimin e ekipeve shkollare dhe komunale. Kemi mbajtur sesione mbështetëse për ekipet e shkollave fillore dhe të mesme të ulta si dhe sesione mbështetëse për ekipet e shkollave të mesme të larta, në bashkëveprim me ECMI dhe UNICEF. Sesionet janë mbajtur në 15 komuna (Kamenicë, Gjiilan, Podujevë, Ferizaj, Shtime, Suharekë, Pejë, Gjakovë, Lipjan, Dragash, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Prizren, Obiliq, Vushtrri. Në këtë kuadër po përkrahen komunat në hartimin e planeve të tyre të veprimit për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes, të cilat presim të shënojnë rezultate të ndjeshme.

MASHTI ka hartuar edhe pakon e 12 moduleve tematike për mbrojtjen e fëmijës, në përputhje me temat që i adreson ligji për mbrojtjen e fëmijës. Krahas moduleve tjera trajtohet edhe braktisja e shkollimit, parandalimi i martesave të hershme, prandalimi i trafikimit dhe mosdiskriminimi.

Tutje MASHTI realizoi edhe takime pune me komunat: Skënderaj, Viti, Drenas dhe Deçan, me përkrahje nga OSBE. Sipas raportimeve në SMIA, sivjet i kemi 191 (0.09%) nxënës braktisës në arsimin 1-9, prej tyre 102 djem dhe 89 vajza. Ndërkaq, ose 1005 ((2.33%)nxënës braktisës në arsimin 10-12, prej tyre 792 djem dhe 213 vajza.

Në Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) të braktisjes, brenda Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim po vazhdojnë raportimet, ndonëse ende të vogla. Te ky sistem i kemi këto raportime nëpër vite:

Viti shkollor	Raste në rrezik të braktisjes
2018/19	133 raste
2019/20	53 raste
2020/21	67 raste
2021/22	49 raste
2022/23	81 raste

Duke i trajtuar rastet në rrezik të braktisjes ndikohet drejtpërdrejt në uljen e braktisjes.

Shkollat që raportojnë ne i konsiderojmë cilësore ngaqë janë të përkushtuara në trajtimin e problemeve që e sfidojnë mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijëve.

Shkollat që gjatë vitit 2022/23 kanë raportuar e trajtuar rastet në rrezik të braktisjes dhe ato të dhunës:

1	Prishtinë	Asim Vokshi
2	Prishtinë	Gjergj Fishta
3	Prishtinë	Iliria
4	Prishtinë	Naim Frashëri
5	Prishtinë	Pjetër Bogdani
6.	Prishtinë	Hilmi Rakovica
7.	Prishtinë	Shkëndija
8	Prishtinë	Emin Duraku
9	Prishtinë	Meto Bajraktari
10	Prishtinë	Avni Rrustemi
11	Prishtinë	Zenel Hajdini
12	Vushtrri	SHMU2
13	Vushtrri	SHMU - 1
14	Vushtrri	Anton Zako Çajupi
15	Vushtrri	Dobërllukë
16	Vushtrri	Mustafë Venhari 2
17	Gjakovë	Mustafa Bakija 1
18	Gjakovë	Zekiria Rexha
19	Gjakovë	Selman Riza
20	Gjakovë	Yll Morina
21	Gjakovë	Isa Boletini
22	Mitrovicë Jugore	Fazli Grejëvci
23	Mitrovicë Jugore	Arkitekt Sinani
24	Ferizaj	Tefik Çanga
25	Viti	Dëshmorët e Vitisë
26	Fushë Kosovë	Vëllezërit Frashëri 2